



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Drejtoria për Shërbime Publike
Uprava za Javne Službe/Directorate of Public Service

Data/Datum/Date:	13.01.2025
Nr.Br.No:	08/01
Për/ Za/To:	Subjektet Afariste të Komunës së Shtimës
Nga/Od/From:	Drejtoria për Shërbime Publike - Drejtor Bardhyl Rushiti
Lënda/ Predmet/Subject:	Njoftim

Bazuar në nenin 19,15,13,12, 8 dhe neni 4, paragrafi 4.3 të Rregullores Npi-01/37 datë 31.01.2024, për Orarin e Punës së Bizneseve në Komunën e Shtimes, Drejtoria për Shërbime Publike :

NJOFTIM

Për nder të Ditës Përkujtimore të Masakrës së Reçakut do të jetë ditë pushimi data 15.01.2025.

Kjo datë është e caktuar me Vendim të Kuvendit të Komunës si datë me rëndësi të Veçantë për komunën e Shtimes prandaj me këtë rast ftohen të gjitha subjektet afariste të cilat operojnë në territorin e komunës së Shtimës të jenë të mbyllura për të respektuar dhe nderuar sakrificën e Martirëve dhe Dëshmorëve të rënë në Masakrën e Reçakut.

Në këtë ditë lejohet të punojnë: Furrat e Bukës, Barnatoret Farmaceutike, Pikat e shitjes se karburanteve dhe Gastronomia.

Ndërsa bizneset që do të kujdestarojnë janë: Marketet: “Gryka Market”-Rr. “ Anton Çetta”, “Marigona Market”, “Noli Market 2”, Lindi Market”, Natyra Market”-Rr. “ Adem Jashari”.